

Mrekullitë e Isait

Isai ka pasur mrekulli madhështore sipas dëshirës dhe me lejen e Zotit. Një nga mrekullitë më të mëdha të tij ishte se ai ishte i lindur pa baba. Ai gjithashtu foli kur ishte foshnjë në djep për të mbrojtur nënën e tij kundër bijve të Israilit që e akuzuan atë për rënie në mëkat.

“E që duke qenë në djep (foshnje) u flet njerëzve, e edhe si i rritur e që është nga të përsosurit.”
Kur'an 3:46

Isai gjithashtu i ka ngjallur të vdekurit, i ka shëruar të sëmurit në lëkurë dhe të verbërit, të gjitha këto me lejen dhe vullnetin e Zotit:

“E (pastaj) do ta dërgojë atë Pejgamber te bijtë e Israelit (të cilëve do t'u thotë): ‘U solla një mrekulli nga Zoti juaj. Do të bëj diçka prej balte në formë shpendi, dhe do të fryej në të, e me urdhërin e Perëndisë do të bëhet shpend. Dhe do të shërojë të verbërit dhe të sëmurit në lëkurë dhe me emrin e Perëndisë do t'i ngjallë të vdekurit. Ju informoj juve çka bani dhe çka ruani në shtëpitë tuaja. Në këto, nëse jeni besimtarë të vërtetë, me të vërtetë, ka argumente për ju.” Kur'an 3:49

Por fakti se isai (paqja qoftë mbi të) ka kryer mrekulli nuk do të thotë se ai ishte më shumë se një rob i përlurur i Zotit (Allahut) dhe i Dërguar i Tij. Në fakt shumë prej të dërguarve kanë kryer mrekulli, duke përfshirë Nuhun, Musain dhe Muhamedin (paqja qoftë mbi ata të gjithë), dhe këto mrekulli u bënë vetëm me lejen e Allahut, në mënyrë që të dëshmojnë vërtetësinë e të dërguarit.

Kryqëzim apo gjoja kryqëzim?

Perspektiva Islame është se Isai nuk është kryqëzuar, por është ngritur në qiej. Kjo pikë sqarohet më tej në ajetet e mëposhtme të Kur'anit:

“Po ata as nuk e mbytën as nuk e gozhduan (nuk e kryqëzuan në gozhdë), por atyre u përngjau (një person). Ata që nuk u pajtuan rreth (mbytjes së) tij, janë në dilemë për të (për mbytje) e nuk kanë për të kurrfarë dije të saktë, përveç që iluzojnë. E ata me siguri nuk e mbytën atë. Por, Perëndia e ka ngritur pranë Vetes (në një vend që nuk e arrijnë njerëzit). Se Perëndia, është i Plotëfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm.” Kur'an 4:157-158

Rikthimi i Isait

Muslimanet besojnë se Isai do të rikthehet para Kijametit (Ditës së Gjykimit), sërish në tokë. Zoti thotë:

Ai do të zbres si musliman (që u bindet ligjeve të Zotit) dhe do t'i thërrasë të tjerët në Islam, duke refuzuar ata që nuk e morën atë si rob dhe të dërguar të Zotit Një dhe të Vërtetë. Isai ka lindur, do të kthehet dhe do të vdesë duke qenë musliman.

“Me të vërtetë, ai (Isai), është shenjë e Çastit (Ditës së Kijametit).”
Kur'an 43:61

Përfundim

Muslimanët e trajtojnë isain në të njëjtën mënyrë si edhe të gjithë pejgamberët e tjerë të Zotit. Ata e respektojnë dhe e duan atë shumë, megjithatë, ata nuk e adhurojnë atë, sepse adhurimi është vetëm për Zotin që e krijoi atë dhe gjithçka që ekziston. Isai nuk është Zot, as nuk është i biri i Zotit, as nuk është tre qenie në një.

Zoti u thotë muslimanëve të pajtohen në shprehjet e përbashkëta dhe të gjejnë mirëkuptim mes tyre dhe njerëzve të Shkrimeve të Shenjta (hebrenjve dhe të krishterëve). Ai thotë:

“Thuaju (o i Dërguar): ‘O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njejtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: të mos adhurojmë, pos Allahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos konsiderojmë njëri - tjetrin zotër pos Allahut!’ E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: ‘Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë (besuam një Zot)!’ ”

Kur'an 3:64

E vërteta për Isain

“ Ai (Isai) tha: ‘Unë jam rob i Allahut, mua më ka dhënë (ka caktuar të më japë) librin dhe më ka bërë Pejgamber.’ ”
Kur'an 19:30

Informacion

t 045-633-370 w islamifejaeventete.com e broshurat@gmail.com

kuptimet
themelore

islamifejaeventete.com

E Vërteta për Isain

Islami është fe e pastër monoteiste, ose, me fjalë të tjera, adhurohet vetëm Zoti Një, i vetëm dhe i vërtetë - i njohur në arabisht si "Allahu". Islami gjithashtu është fe e pejgamberëve të shumtë dhe të të dërguarëve të mëdhenj, e një ndër ta është edhe Isai (paqja qoftë mbi të), një njeri, emri i të cilit është i njohur në pothuajse çdo familje. Një njeri shumë i respektuar dhe i nderuar nga të dy besimet e mëdha: Islami dhe Krishterimi. Ky njeri çfarë lidhje ka me Islamin?

Isai, Pejgamber dhe i Dërguar

Në judaizëm, Isai (paqja qoftë mbi të) është mohuar si Mesih. Kjo është në kontrast të plotë me të krishterët, të cilët e adhurojnë si hyjni, apo bir i Zotit. Islami qëndron në mes, dhe në fakt e pranon Isain si Pejgamber të nderuar, i Dërguar i Zotit, dhe si Mesih. Ai nuk është as Zoti, e as nuk është pjesë e Trinitetit.

"Ai (Isai) tha: 'Unë jam rob i Allahut, mua më ka dhënë (ka caktuar të më japë) librin dhe më ka bërë Pejgamber.'"

Kur'an 19:30

Muslimanët e trajtojnë Isain njësoj si të gjithë pejgamberët e Zotit, të respektuar dhe shumë të dashur. Mohimi i tij, apo i ndonjë pejgamberi ose të dërguari tjetër në Islam si p.sh. Musait, Ibrahimit apo i Muhamedit (paqja qoftë mbi ta), shkakton mohimin e njerës nga bazat e besimit Islam. Pejgamberët nuk janë për t'u adhuruar, sepse adhurimi është vetëm për Zotin, pasi që Ai i krijoi ata dhe gjithçka që ekziston.

Isai (Jezusi) si Zot

Koncepti i Jezusit si Zot, ose i lindur apo i biri i Zotit, është në kundërshtim me Dhjatën e Vjetër, me Kur'anin dhe pasuse të shumta në Dhjatën e Re.

Ajete të shumta kur'anore tregojnë qartë se Jezusi nuk ishte Zot, as i lindur apo i biri i Zotit, sepse nuk i takon Madhërisë së Zotit për të pasur fëmijë. Pretendimi se Zoti ka djalë do të thotë që cilësitë dhe kufizimet e njeriut t'ia mveshësh Zotit të Madhërisëm, kurse Zoti është shumë larg nga të meta të tilla.

"Me të vërtetë, kanë mohuar (të Vërtetën) ata që thonë: 'Me siguri Perëndi është Mesihu – i biri i Merjemes!'. E, Mesihu tha: 'O bijt e Israelit, adhuroni Perëndinë, që është Zoti im dhe Zoti juaj.'"

Kur'an 5:72

"Nuk i takoi (nuk ka nevojë) Allahu të ketë ndonjë fëmijë, i pastër është Ai, kur dëshiron një send Ai vetëm i thotë atij: 'Bëhu!'. Ai menjëherë bëhet."

Kur'an 19:35

Një i krishterë duhet ta pyes veten: një Zot, i cili një herë ishte fëmijë i dobët e i pafuqishëm, që nuk mund të mbijetojë pa ushqim, pije apo gjumë, a mund të jetë Zoti i Gjithëfuqishëm i përshkruar në Dhjatën e Vjetër? Sigurisht se jo!

"E mos thoni: 'Tre' (trimi). Pushoni (së thëni), se është më mirë për ju.

Allahu është vetëm një Allah; larg qoftë asaj

që Ai të ketë fëmijë. ç'ka ka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij.

Mjafton që Allahu është Planifikues i pavarur.'" Kur'an 4:171

Sa për ata që vazhdojnë në blasfeminë e tyre Zoti thotë:

"E nëse s'pushojnë nga ajo që thanë (tre zotëra), do t'i kapë dënim i dhembshëm, ata që nuk besuan prej tyre." Kur'an 5:73

Merjemja, nëna e Isait

Virgjëresha madhështore, Merjemja, ka një status të lartë në Islam sa që një kapitull i tërë i Kur'anit është e emëruar sipas saj. Allahu thotë:

Pejgamberi Muhamed (paqja qoftë mbi të), na e përkujton statusin e saj të lartë me fjalën e tij: **"Më e mira prej grave të botës ishte Merjemja (në kohën që ka jetuar ajo)."**

Lindja e Isait

Meleku Xhibril u dërgua për të Merjemja në formën e njeriut, me përgëzimin e fëmijës që do të lindte mrekullisht pa baba.

"Ne dërguam tek ajo engjëllin – Xhibrilin dhe ai iu paraqit asaj në formën e mashkullit të zbvilluar mirë. Ajo i tha: 'Unë kërkoj që të më mbrojë Mëshiruesi im – prej teje, nëse i druan Perëndisë.'"

"Përkujto kur engjujt i thanë: 'Oj Merjeme, Allahu të dalloj ty (me besim e karakter), dhe të lartësoi mbi gratë e botës.'"

Kur'an 3:42

Ai tha: 'Unë jam vetëm i dërguari i Zotit tënd, që të të dhurojë ty një djalë të pastër.' (Merjemja) tha: 'Si mund të kem unë djalë, kur asnjë mashkull nuk më ka prekur, e unë nuk jam e pamoralshme!' Tha (Xhibrili): 'Kjo është kështu!' – ka thënë Zoti yt: 'Kjo për Mua është lehtë (të krijoj njeriun pa babë). Dhe, ta bëjmë Ne atë argument për njerëzit dhe mëshirë nga Ne. Dhe, kjo është punë e kryer.'" Kur'an 19:17-21

Disa pretendojnë se lindja e tij e mrekullueshme është dëshmi për natyrën hyjnore të Isait. Megjithatë, Isai nuk ishte i pari që do të lindte në mënyrë të mrekullueshme, para tij Pejgamberi Adem (paqja qoftë mbi të) lindi pa baba dhe pa nënë. Zoti thotë:

"Vërtet, çështja e Isait (të lindur pa baba) te Allahu është sikurse çështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu, e pastaj atij i tha 'Bëhu! ai u bë. E vërtetë është (kjo) nga Zoti yt, e ti kurrësi mos u bën nga ata që dyshojnë."

Kur'an 3:59-60

Sigurisht, nëse Isai meriton të adhurohet për shkak se ka lindur pa baba, atëherë Ademi është më shumë meritator që të adhurohet sepse u krijua pa nënë dhe pa baba.

Cili është mesazhi i tij?

Isai ishte dërguar te bijtë e Israilit për të konfirmuar mesazhin e të gjithë pejgamberëve para tij - që ta besojnë Zotin e Vetëm dhe të Vërtetë (Allahun). Ai ishte njoftuar nga Allahu edhe për Librat e mëparshëm (shpalljet e mëparshme), ashtu si Zoti thotë:

"Ai (Allahu) ia mëson atij librin (besimin), urtësinë, Tevratin dhe Inxhilin." Kur'an 3:48

"Po kur Isai erdhi me argumente tha: 'Erdha te ju me pejgamberllëk dhe erdha t'ju sqaroj atë pjesë që e kundërshtonit, pra kimi frikë Allahun dhe më respektoni mua! S'ka dyshim, se Allahu është Ai Zoti juaj, andaj Atë adhuroni! Kjo është rrugë e drejtë!'" Kur'an 43:63-64

Si një njeri i nderuar me shpallje nga Zoti, Isai u bindet urdhrave të Zotit. Si i tillë, ai ishte një "musliman" - që u bindet dëshirave dhe urdhrave të Zotit.